



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 571/6 prot.

Datë 26.03.2026

V E N D I M
Nr. 426/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75971-02-12-2026, me objekt: “Shërbim Printimi i Menaxhuar”, me fond limit 31,207,000 (tridhjetë e një milion e dyqind e shtatë mijë) Lekë pa TVSH ose 323,690 (treqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) euro pa TVSH lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Vazhdimi i shqyrtimit në themel të pjesës tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit të mësipërme.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të mësipërme.

Ankimues:

Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK me NIPT L01606034A dhe adresë Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13-02-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75971-02-12-2026, me objekt: “Shërbim Printimi i Menaxhuar”, me fond limit 31,207,000 (tridhjetë e një milion e dyqind e shtatë mijë) Lekë **pa TVSH** ose 323,690 (treqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) euro pa TVSH lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 23.02.2026, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankimi elektronik A/2026/6359, protokolluar me nr.571/2026 prot., datë 24.02.2026 i operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës me nr. 668/6 prot., datë 25.02.2026, me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK lidhur me dokumentat e tenderit, në procedurën e prokurimit me nr. REF-75971-02-12-2026, me objekt “Shërbim Printimi i Menaxhuar”, protokolluar me tonën me nr. 571/1 prot., datë 27.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin se me vendimin e ndërmjetëm nr. 30/2026, datë 25.02.2026, KSHA ka ndërprerë afatin 5 ditor për marrjen e vendimit në lidhje me ankesën e paraqitur, pasi shfaqet e nevojshme kryerja e verifikimeve pranë organeve të tjera.

II.5. Me shkresën me nr. 668/10 prot., datë 12.03.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK lidhur me dokumentat e tenderit, në procedurën e prokurimit me nr. REF-75971-02-12-2026, me objekt “Shërbim printimi i menaxhuar”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 571/2 prot., datë 13.03.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka dorëzuar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, vendim KSHA 45/2026 ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë duke argumentuar se:

[...]

Për sa më lart, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në kërkesën për prokurim paraqitur pranë OBP sh.a në lidhje me objektin e prokurimit "Shërbim printimi i menaxhuar", ndër të tjera ka paraqitur dhe të dhënat teknike në lidhje me specifikimet teknike, të cilat janë implementuar në DST, Shtojca 6.

Ndodhur në kushtet ku disa nga pretendimet e Operatorit ekonomik ankimues (të pasqyruara në Formularin e ankesës) lidhen në mënyrë direkte me Specifikimet teknike, KSHA nëpërmjet shkresës me Nr. 668/7 Prot., datë 25.02.2026, iu drejtua Autoritetit Kontraktor, Përfitues konkretisht Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për rishikimin e specifikimeve teknike, sipas pretendimeve të ngritura nga ankimuesi duke mbajtur në konsideratë parimet e LPP-së si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nga korrespondenca zyrtare e OBP sha me Autoritetin Kontraktor Përfitues, ky i fundit nëpërmjet shkresës me Nr. 1673/1 Prot. datë 09.03.2026 (regjistruar në OBP sha me Nr. 668/8 Prot. datë 09.03.2026) ka argumentuar si më poshtë vijon:

"[...] Operatori ekonomik ankimues ka parashtruar pretendimet lidhur me specifikimet teknike si me poshtë;

Specifikimet e kundërshtuara:

Fotokopje Multifunction B&W MFP Basic

Kapaciteti në hyrje (Input Capacity min):

- Ishte: Min. 3500 fletë*
- Bëhet: Min. 800 fletë*

Kapaciteti në dalje (Output Capacity min Standard):

- Ishte: Min. 3000 fletë*
- Behet: Min. 500 fletë*

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa fillestare për një kapacitet minimal në hyrje dhe në dalje prej 3000 fletësh është karakteristike për pajisje të klasës së avancuar ose për përdorim me volum shumë të lartë printimi. Duke qenë se pajisja kërkohet në kategorinë Basic dhe jo high volume, një kapacitet minimal prej 800 dhe 500 fletësh konsiderohet i mjaftueshëm për të garantuar përdorimin normal të pajisjes në mjedis institucional. Ky rishikim nuk cenon

funksionalitetin e pajisjes, ndërkohë që siguron përputhje më të mirë me standardet e tregut dhe rrit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me pikën b) - Fotokopje Multifunction Color MFP Basic

Kapaciteti në hyrje (Input Capacity min):

- Ishte: Min. 6000 Flete*
- Bëhet: Min. 500 fletë*

Kapaciteti në dalje (Output Capacity min Standard)

- Ishte: Min. 4000 fletë*
- Bëhet: Min. 300 fletë*

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kapaciteti minimal në hyrje prej 6000 fletësh dhe në dalje prej 4000 fletësh është i lidhur me pajisje të kategorisë së lartë të prodhimit (production printers), të cilat tejkalojnë nevojat reale të institucionit për një pajisje Color Multifunction Basic. Vendosja e një kapaciteti minimal prej 500 dhe 300 fletësh siguron funksionalitet të plotë për përdorim institucional dhe është në përputhje me standardet teknike të shumicës së pajisjeve të kësaj kategorie në treg. Ky ndryshim kontribuon në harmonizimin e specifikimeve me parimet e proporcionalitetit dhe konkurrencës në procedurat e prokurimit publik.

Në lidhje me pikën c) - Skaner Tipi 3 Shpejtësia e skanimit e kërkuar nga operatori ekonomik është më e ulët se nevojat e Autoritetit Kontraktor. Për këtë arsye nuk mund të merret për bazë argumentimi i paraqitur nga operatori ekonomik, pasi mënyra dhe vendi ku do të kryhet skanimi nuk janë të shpërndara në mënyrë proporcionale.

Në praktikë, për nevojat e Autoritetit Kontraktor ndodh që të jetë e nevojshme skanimi i një numri të madh dokumentesh brenda një afati kohor të shkurtër, çka kërkon pajisje me performancë më të lartë.

Gjithashtu, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik është më e ulët se standardet e përcaktuara nga AKSHI, sipas të cilave shpejtësia e skanimit duhet të jetë jo më pak se 45 ppm/90 ipm (300 dpi).

Duke u bazuar në këto standarde, specifikimet teknike për shpejtësinë e skanimit ndryshohen si më poshtë:

Shpejtësia e Skanimit (Scanning Speed)

- *Ishte: Min. 50 ppm/100 ipm (300 dpi)*
- *Bëhet: Min. 45 ppm/90 ipm (300 dpi)*

Në lidhje me pikën d) - Treguesit sasiorë të shërbimit

Sasia e letrës nuk përputhet plotësisht me numrin e printimeve, pasi jo çdo printim realizohet vetëm në një anë të fletës (one-sided). Një pjesë e printimeve do të realizohen në të dy anët e fletës (double-sided).

Gjithsesi, kjo situatë nuk ndikon në përlllogaritjen e fondit limit, si dhe nuk përbën kosto shtesë për operatorin ekonomik, pasi numri i fletëve të letrës është një zë më vete në përlllogaritjen dhe faturimin që do të realizohet nga operatori ekonomik

Në lidhje me pikën e) Specifikimet teknike për software Pas rishikimit të specifikimeve teknike, u vendos që të hiqen specifikimet e detajuara mbi teknologjinë, databazën, serverin etj., ndërsa operatori ekonomik do të ketë detyrimin të garantojë sigurinë e informacionit brenda Autoritetit Kontraktor.

Kërkesat për software-in e menaxhimit dhe monitorimit ndryshohen si më poshtë:

Menaxhimi dhe kontrolli i realizimit të shërbimit, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor, do të kryhet nëpërmjet përdorimit të një sistemi softëare të dedikuar. Ky software do të siguroher nga operatori ekonomik dhe duhet të garantojë sigurinë, funksionalitetin dhe vazhdueshmërinë procesit të punës. Gjithashtu, sistemi duhet të jetë plotësisht i përputhshëm dhe i integrueshëm me të gjitha pajisjet që do të ofrohen nga operatori ekonomik, duke munderuar menaxhimin dhe monitorim efektiv të shërbimit.

Për softëare-in e menaxhimit të pajisjeve të printimit, operatori ekonomik do të ketë akses vetëm për të parë numrin e faqeve të printuara dhe të fotokopjuara. Ky akses do të realizohet vetëm në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Ndërkohë, Sektori i IT-së do të jetë përgjegjës për menaxhimin e dokumenteve të fotokopjuara dhe të skamuara."

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

II.2. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e Dokumenteve Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, me arsyetimin se: "...AK ka vendosur kriteret të cilat për nga mënyra e vendosjes e kufizojnë konkurrencën, pasi për çdo kriter të veçantë të vendosur, duhet shtuar termi "Ekuivalente"... Kriteri kërkon që Operatori ekonomik të ketë: "c. 3(tre) nga punonjësit e mesiperm te permendur ne piken a dhe b, duhet te jene te trajnuar/certifikuar nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar le paisjeve (pika 2.3.2 tabela nr. 1-5) te ofertuara ne kete procedure prokurimi ose nga organe te akredituar kompetente, per sherbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Ne lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe certifikimi perkates"është kufizues për pjesëmarrjen e gjerë të Operatorëve në procedurë, pasi e kufizon ekspertizën vetëm te një model produkti, ndërkohë duhet të fokusohet te lloji i produktit jo modeli....", KSHA gjykon se:

Në Dokumentet e Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, Autoriteti Kontraktor, OBP sha, ka përcaktuar se:

"2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

a. 2 (dy) inxhinierë te cilet duhet te jene te diplomuar ne fushat: teknologji informacioni IT/ informatike/ inovacion/ elektronike/ inxhinieri mekanike. Per keta punonjës te paraqitet diploma e arsimit te larte dhe kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

b. 3 (tre) punonjës teknikë te cilet do te kryejne funksionin e mirembajtjes se paisjeve dhe do te realizojne asistencen teknike gjate kryerjes se sherbimi. Per keta punonjës te paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

c. 3 (tre) nga punonjësit e mesiperm te permendur ne piken a dhe b, duhet te jene te trajnuar certifikuar nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar te paisjeve (pika 2.3.2 tabela nr. 1-5) t ofertuara ne kete procedure prokurimi ose nga organe te akredituar kompetente, per sherbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Ne lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe certifikimi perkates.

d. Nje punonjes (mund te pershihen edhe punonjesit e pikes a dhe b) duhet te jete i certifikua konfigurimet ne rrjet ne nivel ÇNA ose ekuivalent. Ne lidhje me kete punonjës të paraqi kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues dhe certifikimi perkates.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor."

Në procesverbalin "PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM" të publikuar në SPE nga ana e Autoritetit Kontraktor është argumentuar vendosja e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

Argumentimi: Kjo kërkesë vjen si kusht kryesor për kapacitetin profesional të OE ofertues. Profili i kërkuar lidhet ngushtë me objektin e prokurimit dhe le të hapur çdo fushë të teknologjive të informacionit, elektronikës, inovacionit dhe çdo fushë tjetër të diplomimit në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht që lidhet me objektin e prokurimit që është shërbim printimi dhe fotokopjimi. Kërkohet numri i punonjësve si më sipër, si numër minimal për zbatimin e grafikut të parashikuar të punës ku do të zbatohet kjo marrëveshje kuader dhe numrit të lartë të pajisjeve që kërkohet të mirëmbahet.

Kërkesa për punonjësit teknikë i shërben zbatimit në terren të kontratës, të cilët do të jenë në gjendje të përballojnë pyetje, paqartësi, defekte apo çdo nevojë që lind gjatë zbatimit të kësaj kontrate.

Shërbimi do të shtrihet në disa vende të ndryshme, ndaj kërkohet strukturë teknike e mjaftueshme që të mund të mbulojë të gjitha zonat në mënyrë të njëkohshme. Pas vendosjes së printerëve, nevojitet monitorim dhe mirëmbajtje. Inxhinierët e fushave të mësipërme janë të aftë të realizojnë zbulimin e defekteve, zëvendësim të komponentëve elektronikë/mekanikë etj. Printerët që përdoren në institucione publike mund të përpunojnë dokumente konfidenciale, Inxhinierët e IT dhe sigurisë mund të garantojnë që pajisjet të konfigurohen në mënyrë që të respektojnë protokollet e sigurisë dhe privatësisë, duke parandaluar rrjedhje informacioni. Ky është një shërbim me shtrirje të gjerë, që kërkon punonjës të certifikuar për të garantuar cilësi, siguri dhe vazhdimësi. Prandaj kërkesa për 2 inxhinierë është një kusht për suksesin e projektit.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë përfshin Krujë, Fushë Krujë, Vorë, Kamëz, Tiranë dhe shërbimi për printimin dhe pajisjen me printera duhet të garantojë: 1) Mbulesë të plotë territoriale, 2) Reagim të shpejtë në rast ndërhyrjeje teknike, 3) Prezencë të stafit teknik për pikat përkatëse.

Kjo shpërndarje gjeografike e bën të pamundur mbulimin nga një numër më i vogël teknikësh pa rrezikuar cilësinë dhe kohëzgjatjen e reagimit.

Njesia e Prokurimit ka përcaktuar si kriter të domosdoshëm për kualifikim angazhimin e 3 (tre) punonjësve teknikë të specializuar për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe asistencës teknike duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të shërbimit, vëllimin e punës dhe kompleksitetin teknik, nevojën për ndërhyrje të shpejtë dhe të koordinuar, rëndësinë e vazhdimësisë së shërbimit për institucionin përfitues (në këtë rast, drejtornë Vendore të Policisë Tiranë).

Kërkesa lidhur me një punonjës (mund të përfshihen edhe punonjësit e pikës a dhe b) duhet të jetë I certifikuar për konfigurimet në rrjet në nivel ÇNA ose ekuivalent:

Objekti i procedurës nuk lidhet vetëm në ofrimin e shërbimit mekanik të printimit, por përfshin instalimin, konfigurimin, integrimin dhe funksionimin e pajisjeve të printimit në infrastrukturën ekzistuese të rrjetit të Autoritetit Kontraktor, e cila është një infrastrukturë e ndjeshme për shkak të natyrës së institucionit përfitues. Në këtë kuadër, kërkesa për një punonjës të certifikuar ÇNA ose ekuivalent synon garantimin e funksionit të sigurt, të qëndrueshëm dhe të pandërprerë të shërbimit, si dhe ndërhyrjen në rrjet pa shkaktuar probleme.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/a,b,c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Në Nenin 2 "Qëllimi të Ligjit Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se: "Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".

Në Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të LPP-së Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën".

Në Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor", pika 1 të Ligjit Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përpi legjislacionin në fuqi".

Në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknika si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilesie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 4, parashikohet se:

"4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe lose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit: dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë."

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve reale të Operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të natyrës dhe llojit të kontratës, Autoriteti Kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Për sa më lart, në dokumentet e tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.3, Autoriteti Kontraktor, ka parashikuar personelin e nevojshëm që duhet të disponojnë Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Qëllimi i kësaj kërkesë mbështetur dhe në natyrën e shërbimit objekt i këtij ankimi, është që Ofertuesi të provojë dhe të dokumentojë se disponon personel të kualifikuar dhe të çertifikuar, i cili është thelbësor për ekzekutimin e kontratës me sukses, sipas specifikime teknike.

Referuar frymës së legjislacionit të prokurimit publik, ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DT, ku Ofertuesit fillimisht duhet të deklarojnë se disponojnë personelin e kërkuar nga AK.

Në mbështetje të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26, pika 6, përpara njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, Ofertuesi i kualifikuar i pari ka detyrimin ligjor që të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për punonjësit e deklaruar sipas Shtojcës 10 të DT.

Në lidhje me pretendimin e OE ankimues se: "...Logjika e kriterit sipas AK është që punonjësit e diplomuar për inxhinieri të kenë edhe certifikime për pajisjet e printimit fotokopjimit, pra e ngushton konkurrenceën në mënyrë artificiale dhe tërësisht të panevojshme, pasi nuk ka asnjë argument ligjor apo teknik që mbështet pretendimin e AK. Prandaj kriteri duhet të modifikohet

tërësisht pasi përbën kufizim të panevosjëm të konkurrencës e për rrjedhim, keqmenaxhim të fonvete publike...", KSHA vëren se në pikën 2.3.3 të Kapacitetit teknik, përcaktohet se:

"2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

a. 2 (dy) inxhinierë të cilët duhet të jenë të diplomuar në fushat: teknologji informacioni IT/informatike/ inovacion/ elektronike/ inxhinieri mekanike. Për këta punonjës të paraqitet diploma e arsimit të lartë dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

b. 3 (tre) punonjës teknikë të cilët do të kryejnë funksionin e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe do të realizojnë asistencën teknike gjatë kryerjes së shërbimit. Për këta punonjës të paraqitet kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

c. 3(tre) nga punonjësit e mesipër të përmendur në pikën a dhe b, duhet të jenë të trajnuar/certifikuar nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar të pajisjeve (pika 2.3.2 tabela nr. 1-5) të ofertuara në këtë procedurë prokurimi ose nga organe të akredituar kompetente, për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Në lidhje me këta punonjës të paraqitet edhe çertifikimi perkates.

d. Një punonjës (mund të përfshihen edhe punonjësit e pikës a dhe b) duhet të jetë i certifikuar për konfigurimet në rrjet në nivel CCNA ose ekuivalent. Në lidhje me këta punonjës të paraqitet kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues dhe çertifikimi perkates.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor."

Nga një interpretim i kriterit të sipërcituar, KSHA arsyeton se AK për realizimin e kontratës objekt prokurimi ka kërkuar 2 (dy) inxhinierë të diplomuar në teknologji informacioni/IT/informatike /inovacion / elektronike inxhinieri mekanike; 3 (tre) punonjës teknikë të cilët do të kryejnë funksionin e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe do të realizojnë asistencën teknike gjatë kryerjes së shërbimit, pra, gjithsej 5 (pesë) punonjës.

Në lidhje me punonjësit e sipërcituar, AK nëpërmjet gërmës "c" ka kërkuar se: 3 (tre) prej 5 (pesë) punonjësve të deklaruar duhet të jenë të trajnuar/certifikuar nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar të pajisjeve (pika 2.3.2 tabela nr.1-5) të ofertuara në këtë procedurë prokurimi ose nga organe të akredituar kompetente, për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisjesh elektronike.

Në lidhje me pretendimin e ankimuesit se kërkesa për certifikim/trajnim duhet të modifikohet vetëm për punonjësit teknikë, KSHA arsyeton se AK ka hartuar këtë kërkesë duke mbajtur në konsideratë parimet e sanksionuara në legjislacionin e prokurimit publik. Konkretisht:

Kjo kërkesë është gjithpërfshirëse duke i ofruar në këtë mënyrë mundësi pjesëmarrjeje të gjithë Ofertuesve si atyre që kanë Inxhinierët të certifikuar ashtu dhe ofertuesve që kanë punonjës teknikë të certifikuar.

Gjithashtu, kjo kërkesë është në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe garantimit të konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, pasi nuk kufizohet në një kategori specifike punonjësish. Përkundrazi, ajo u ofron operatorëve ekonomikë fleksibilitet në përmbushjen e kriterit, duke lejuar që certifikimet/trajnimet përkatëse të zotërohen nga cilido prej punonjësve të stafit (inxhinier apo punonjës teknik) të angazhuar për realizimin e shërbimit. Në këtë mënyrë sigurohet një trajtim i barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nxitet pjesëmarrja sa më e gjerë në procedurën e prokurimit, duke lejuar pjesëmarrjen e të gjithë ofertuesve që plotësojnë kërkesat teknike, pavarësisht nga kombinimi i stafit të certifikuar.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë konsiderohet proporcionale me objektin e kontratës dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës, pasi u jep mundësi pjesëmarrjeje si operatorëve ekonomikë që disponojnë inxhinierë të certifikuar/trajnuar, ashtu edhe atyre që kanë punonjës teknikë të certifikuar/trajnuar.

Në lidhje me pretendimin e ankimuesit se: "...Në lidhje me këta punonjës të paraqitet edhe certifikimi përkatës është kufizues për pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve në procedurë, pasi e kufizon ekspertizën vetëm te një model produkti, ndërkohë duhet të fokusohet te lloji i produktit, jo modeli, prandaj duhet shtuar termi "Ekuivalent"...", KSHA gjykon se:

Në DT, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.3. gërma "c", Autoriteti Kontraktor ka parashikuar se: "...c. 3(tre) nga punonjësit e mesiperm te permendur ne piken a dhe b, duhet te jene te trajnuar/ certifikuar nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar te paisjeve (pika 2.3.2 tabela nr. 1-5) te ofertuara ne kete procedure prokurimi ose nga organe te akredituar kompetente, per sherbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Ne lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe certifikimi perkates...".

Mbështetur në objektin e prokurimit, i cili konsiston në ofrimin dhe menaxhimin e shërbimit të printimit, KSHA arsyeton se ky shërbim do të implementohet pranë Autoritetit Kontraktor Përfitues, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, i cili ka një shtrirje territoriale të gjerë, duke përfshirë Krujën, Fushë-Krujën, Vorën, Kamzën dhe Tiranën. Kjo kërkon që shërbimi i printimit

dhe pajisja me printera të sigurojë mbulim të plotë territorial, si dhe të garantojë efikasitet dhe shpejtësi në ndërhyrjet teknike.

Stafi teknik i kërkuar sipas gërmeve "a" dhe "b" të pikës 2.3.3 është përgjegjës për impleme monitorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të printimit, duke identifikuar dhe adresuar problematikë operative. Duke marrë në konsideratë natyrën e institucionit dhe faktin se printer mund të përdoren për përpunimin e dokumenteve konfidenciale, Autoriteti Kontraktor vlerëson se është e domosdoshme që një pjesë e stafit teknik të jetë i trajnuar/çertifikuar.

Ky certifikim duhet të jetë i siguruar ose nga prodhuesit ose distributorët e autorizuar të pajisjeve të ofertuara në këtë procedurë prokurimi (sipas pikës 2.3.2, tabela nr. 1-5), ose nga organe kompetente të akredituara për mirëmbajtjen e printerave dhe pajisjeve elektronike.

Çertifikimi/trajnimi nuk është vetëm një dokument formal, por ai shërben si dokument provues dhe garantues për OE duke duke siguruar që punonjësit e tij, të cilët do të përfshihen në procesin e ekzekutimit të kontratës kanë njohuritë e nevojshme profesionale mbi printerat objekt prokurimi si dhe janë kompetentë për konfigurimin dhe mirëmbajtjen e tyre në përputhje me standardet teknike si dhe në harmoni me protokollin e sigurisë dhe privatësisë, duke parandaluar çdo rrjedhje të mundshme të informacionit që mund të ndikojë në funksionimin, performancën dhe stabilitetin e institucionit. Gjithashtu me qëllim pjesëmarrjen e gjerë të Operatorëve ekonomik, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar se ky certifikim/trajnim të jetë realizuar nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar të pajisjeve apo nga organe të akredituara kompetente, për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Qartazi, lëshimi i këtij dokumenti (certifikata/trajnimi) nuk është kufizuar vetëm në një subjekt lëshues, por përkundrazi Autoriteti Kontraktor ka parashikuar disa subjekte ekuivalente të cilat identifikohen si: Prodhues ose Distributor i autorizuar për pajisjet e parashikuara në këtë procedurë prokurimi ose Organe të akredituara kompetente për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisjesh elektronike.

Për sa më sipër, evidentohet se kërkesa e AK në lidhje me certifikimin/trajnimin është në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik në proporcion me objektin e prokurimit si dhe në harmoni me parimet e sanksionuara në LPP.

Në lidhje me pretendimin e ankimuesit se: "...Duhet të modifikohet kërkesa e AK e të bëhet: "c. 3 (tre) nga punonjësit e mësipërm të përmendur në pikën b, duhet të jenë të trajnuar/çertifikuar nga prodhuesit e pajisjeve objekt prokurimi ose ekuivalentët e tyre (pika 2.3.2 tabela nr. 1-5) ose nga organe të akredituara kompetente sipas ligjit për arsimin profesional. Në lidhje me këta punonjës të paraqitet edhe çertifikimi përkatës dhe kontrata e punës."...", KSHA gjykon se:

Në DT, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.3. gërma "c", Autoriteti Kontraktor ka parashikuar se: "...c. 3(tre) nga punonjësit e mesipërm të përmendur në pikën a

dhe b, duhet te jene te trajnuar/ certifikuar nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar te paisjeve (pika 2.3.2 tabela nr. 1-5) te ofertuara ne kete procedure prokurimi ose nga organe ane te akredituar kompetente. per sherbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Ne lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe certifikimi perkates..."

Nga pretendimi ankimuesit ndër të tjera konstatohet modifikimi i kësaj kërkesë: "...ose nga organe te akredituar kompetente, per sherbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike..." në "...ose nga organe të akredituar kompetente sipas ligjit për arsimin profesional...".

KSHA konstaton se në Formularin e ankesës, Operatori ekonomik ankimues, në lidhje me këtë pretendim, nuk ka parashtruar asnjë fakt apo argumentim teknik dhe ligjor ku të mbështetet kërkesa e tij për modifikim.

Në rastin konkret, KSHA gjykon se barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të Autoritetit, qëndron mbi Operatorin ekonomik ankimues, i cili ka detyrimin ligjor që të bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për modifikimin e kriterit/kritereve nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.3. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e Dokumenteve Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, me arsyetimin se "...Shkronja d) e pikës 2.3.3 është tërësisht jashtë qëllimit të objektit të prokurimit, pasi AK nuk do të ndërtojë një rrjet interneti të brendshëm nga fillimi apo infrastrukturë të re rrjeti por vetëm do të lidhë me burimin e energjisë dhe në rrjetin ekzistues të AK disa pajisje për printimin e fotokopjimin e dokumentave të përditshme institucionale. Certifikimi është joproporcional dhe nuk i shërben qëllimit të AK që është prokurimi i shërbimit me cilësinë e kërkuar me cmimin më të ulët, ndërkohë që vetë certifikimi ÇNA, është një nga certifikimet e kushtueshme në sektorin IT dhe përdoret në një fushë tërësisht tjetër nga ajo e objektit të prokurimit të AK. Prandaj duhet të hiqet..." KSHA gjykon se:

Në Dokumentet Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, gërma "d" Autoriteti Kontraktor, OBP sha, ka përcaktuar se:

"2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë: ...d. Nje punonjes (mund te pershihen edhe punonjesit e pikes a dhe b) duhet te jete i certifikuar per konfigurimet ne rrjet ne nivel CCNA ose ekuivalent. Ne lidhje me kete punonjës të paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues dhe certifikimi perkates.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor."

Në procesverbalin "PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM" të publikuar në SPE nga ana e Autoritetit Kontraktor është argumentuar vendosja e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

Argumentimi: Kjo kërkesë vjen si kusht kryesor për kapacitetin profesional të OE ofertues. Profili i kërkuar lidhet ngushtë me objektin e prokurimit dhe le të hapur çdo fushë të teknologjisë së informacionit, elektronikës, inovacionit dhe çdo fushë tjetër të diplomimit në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht që lidhet me objektin e prokurimit që është shërbim printimi dhe fotokopjimi. Kërkohet numri i punonjësve si më sipër, si numër minimal për zbatimin e grafikut të parashikuar të punës ku do të zbatohet kjo marrëveshje kuader dhe numrit të lartë të pajisjeve që kërkohet të mirëmbahet.

Kërkesa për punonjësit teknikë i shërben zbatimit në terren të kontratës, të cilët do të jenë në gadishmeri për çdo pyetje, paqartësi, defekt apo çdo nevojë që lind gjatë zbatimit të kësaj kontrate.

Shërbimi do të shtrihet në disa vende të ndryshme, ndaj kërkohet strukturë teknike e mjaftueshme që të mund të mbulojë të gjitha zonat në mënyrë të njëkohshme. Pas vendosjes së printerëve, nevojitet monitorim dhe mirëmbajtje. Inxhinierët e fushave të mësipërme janë të aftë të realizojnë zbulimin e defekteve, zëvendësim të komponentëve elektronikë/mekanikë etj. Printerët që përdoren në institucione publike mund të përpunojnë dokumente konfidenciale, Inxhinierët e IT dhe siguri mund të garantojnë që pajisjet të konfigurohen në mënyrë që të respektojnë protokollet e siguri dhe privatësisë, duke parandaluar rrjedhje informacioni. Ky është një shërbim me shtrirje të gjerë, që kërkon punonjës të certifikuar për të garantuar cilësi, siguri dhe vazhdimësi. Prandaj kërkesa për 2 inxhinierë është një kusht për suksesin e projektit.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë përfshin Krujë, Fushë Krujë, Vorë, Kamëz, Tiranë dhe shërbimi për printimin dhe pajisjen me printera duhet të garantojë: 1) Mbulesë të plotë territoriale, 2) Reagim të shpejtë në rast ndërhyrjeje teknike, 3) Prezencë të stafit teknik për pikat përkatëse.

Kjo shpërndarje gjeografike e bën të pamundur mbulimin nga një numër më i vogël teknikësh pa rrezikuar cilësinë dhe kohëzgjatjen e reagimit.

Njesia e Prokurimit ka përcaktuar si kriter të domosdoshëm për kualifikim angazhimin e 3 (tre) punonjësve teknikë të specializuar për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe asistencës teknike duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të shërbimit, vëllimin e punës dhe kompleksitetin teknik, nevojën për ndërhyrje të shpejtë dhe të koordinuar, rëndësinë e vazhdimësisë së shërbimit për institucionin përfitues (në këtë rast, Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë).

Kërkesa lidhur me Nje punonjes (mund te pershihen edhe punonjesit e pikes a dhe b) duhet te jete i certifikuar per konfigurimet ne rrjet ne nivel CCNA ose ekuivalent:

Objekti i procedurës nuk lidhet vetëm në ofrimin e shërbimit mekanik të printimit, por përfshin instalimin, konfigurimin, integrimin dhe funksionimin e pajisjeve të printimit në infrastrukturën ekzistuese të rrjetit të Autoritetit Kontraktor, e cila është një infrastrukturë e ndjeshme për shkak të natyrës së institucionit përfitues. Në këtë kuadër, kërkesa për një punonjes të certifikuar CCNA ose ekuivalent synon garantimin e funksionimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe të pandërprerë të shërbimit, si dhe nderhyrjen në rrjet pa shkaktuar probleme.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/a,b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Në Nenin 2 "Qëllimi" të Ligjit Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se: "Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".

Në Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të LPP-së Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

- "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar*

artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën".

Në Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor", pika 1 të Ligjit Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi".

Në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 4, parashikohet se:

"4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licenca profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurin dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizi të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklara disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë."

Duke marrë në konsideratë pretendimin e OE ankimues në lidhje me heqjen e kërkesës parashikuar në DT, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.3, gërma "d KSHA, pasi shqyrtoi dokumentet e tenderti si dhe Procesverbalin për argumentimin dhe miratimi e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim arsyeton se:

Objekti i procedurës nuk lidhet vetëm me ofrimin e shërbimit mekanik të printimit, por përfshi gjithashtu instalimin, konfigurimin, integrimin dhe funksionimin e pajisjeve të printimit m infrastrukturën ekzistuese të rrjetit të Autoritetit Kontraktor. Duke qenë se pajisjet e printimit d të lidhen dhe do të komunikojnë drejtpërdrejt me rrjetin e brendshëm të Autoritetit Kontrakt Përfitues, procesi i instalimit dhe konfigurimit kërkon ndërhyrje teknike në parametrat e rrjeti përfshirë konfigurimin e adresimit IP, lidhjen me serverë, menaxhimin e protokolleve t komunikimit dhe testimin e funksionimit të pajisjeve në mjedisin ekzistues të rrjetit.

Duke marrë në konsideratë natyrën e infrastrukturës së rrjetit të Autoritetit Kontraktor dh rëndësinë e funksionimit të pandërprerë të sistemeve të tij, ndërhyrjet në këtë infrastrukturë duhe të realizohen nga personel teknik me njohuri të specializuara në administrimin dhe konfigurimin rrjeteve kompjuterike. Një ndërhyrje e pasaktë në konfigurimin e rrjetit mund të shkaktoj ndërprerje të shërbimeve, probleme në komunikimin ndërmjet sistemeve apo cenim të stabilitet të infrastrukturës ekzistuese.

Në këtë kuadër, kërkesa për një punonjës të certifikuar me certifikatë CCNA ose ekuivalente syno të garantojë që operatori ekonomik të disponojë kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin instalimit dhe integrimin të pajisjeve në rrjet në mënyrë profesionale dhe të sigurt. Ky certifikim ose një certifikim ekuivalent përfaqëson një standard të njohur ndërkombëtarisht në fushën rrjeteve kompjuterike dhe dëshmon se personeli teknik zotëron njohuritë e nevojshme p konfigurimin, administrimin dhe diagnostikimin e problemeve në rrjet.

CCNA në vetvete është një certifikatë profesionale në fushën e rrjeteve kompjuterike, e c verteton se personi që e disponon ka njohuri bazë dhe praktike për instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve.

Pra Çertifikimi CCNA përfaqëson një standard të njohur ndërkombëtarisht në fushën e rrjete dhe dëshmon se personeli teknik zotëron njohuritë e nevojshme për konfigurimin, integrimin dhe diagnostikimin e problemeve në rrjet.

Kërkesa për këtë certifikim është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, i cili synon garantimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë si dhe garanton ndërhyrje të sigurtë në rrjet pa shkaktuar probleme.

Gjithashtu ndodhur në kushtet ku krahas paraqitjes së certifikatës CCNA, Autoriteti Kontraktor ka lejuar edhe paraqitjen e certifikatave ekuivalente, ky fakt dëshmon se vendosja e kësaj kërkesë nuk ka si qëllim kufizimin e konkurrencës, por përkundrazi kjo kërkesë është gjithpërfshirëse e cila nxit pjesëmarrjen e Operatorëve ekonomik duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën ndërmjet OE.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar), dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

- 1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik "PC STORE" shpk. [...]*

II.6. Me shkresën me nr. 668/10 prot., datë 12.03.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK lidhur me dokumentat e tenderit, në procedurën e prokurimit me nr. REF-75971-02-12-2026, me objekt “Shërbim printimi i menaxhuar”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 571/3 prot., datë 17.03.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, vendim KSHA 45/2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK për modifikimin e dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Me shkresën me nr. 668/10 prot., datë 12.03.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK lidhur me dokumentat e tenderit, në procedurën e prokurimit me nr. REF-75971-02-12-2026, me objekt “Shërbim printimi i menaxhuar”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 571/2 prot., datë 13.03.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka dorëzuar nëpërmjet sistemit të ankësive elektronike aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “PC store” SHPK, vendim KSHA 45/2026 ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë duke argumentuar se:

[...]

Për sa më lart, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në kërkesën për prokurim paraqitur pranë OBP sh.a në lidhje me objektin e prokurimit "Shërbim printimi i menaxhuar", ndër të tjera ka paraqitur dhe të dhënat teknike në lidhje me specifikimet teknike, të cilat janë implementuar në DST, Shtojka 6.

Ndodhur në kushtet ku disa nga pretendimet e Operatorit ekonomik ankimues (të pasqyruara në Formularin e ankesës) lidhen në mënyrë direkte me Specifikimet teknike, KSHA nëpërmjet shkresës me Nr. 668/7 Prot., datë 25.02.2026, iu drejtua Autoritetit Kontraktor, Përfitues konkretisht Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për rishikimin e specifikimeve teknike, sipas pretendimeve të ngritura nga ankimuesi duke mbajtur në konsideratë parimet e LPP-së si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nga korrespondenca zyrtare e OBP sha me Autoritetin Kontraktor Përfitues, ky i fundit nëpërmjet shkresës me Nr. 1673/1 Prot. datë 09.03.2026 (regjistruar në OBP sha me Nr. 668/8 Prot. datë 09.03.2026) ka argumentuar si më poshtë vijon:

"[...] Operatori ekonomik ankimues ka parashtruar pretendimet lidhur me specifikimet teknike si me poshtë;

Specifikimet e kundërshtuara:

Fotokopje Multifunction B&W MFP Basic

Kapaciteti në hyrje (Input Capacity min):

- *Ishte: Min. 3500 fletë*
- *Bëhet: Min. 800 fletë*

Kapaciteti në dalje (Output Capacity min Standard):

- *Ishte: Min. 3000 fletë*
- *Behet: Min. 500 fletë*

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa fillestare për një kapacitet minimal në hyrje dhe në dalje prej 3000 fletësh është karakteristike për pajisje të klasës së avancuar ose për përdorim me volum shumë të lartë printimi. Duke qenë se pajisja kërkohet në kategorinë Basic dhe jo high volume, një kapacitet minimal prej 800 dhe 500 fletësh konsiderohet i mjaftueshëm për të garantuar përdorimin normal të pajisjes në mjedis institucional. Ky rishikim nuk cenon funksionalitetin e pajisjes, ndërkohë që siguron përputhje më të mirë me standardet e tregut dhe rrit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me pikën b) - Fotokopje Multifunction Color MFP Basic

Kapaciteti në hyrje (Input Capacity min):

- *Ishte: Min. 6000 fletë*
- *Bëhet: Min. 500 fletë*

Kapaciteti në dalje (Output Capacity min Standard)

- *Ishte: Min. 4000 fletë*
- *Bëhet: Min. 300 fletë*

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kapaciteti minimal në hyrje prej 6000 fletësh dhe në dalje prej 4000 fletësh është i lidhur me pajisje të kategorisë së lartë të prodhimit (production printers), të cilat tejkalojnë nevojat reale të institucionit për një pajisje Color Multifunction Basic. Vendosja e një kapaciteti minimal prej 500 dhe 300 fletësh siguron funksionalitet të plotë për përdorim

institucional dhe është në përputhje me standardet teknike të shumicës së pajisjeve të kësaj kategorie në treg. Ky ndryshim kontribuon në harmonizimin e specifikimeve me parimet e proporcionalitetit dhe konkurrencës në procedurat e prokurimit publik.

Në lidhje me pikën c) - Skaner Tipi 3 Shpejtësia e skanimit e kërkuar nga operatori ekonomik është më e ulët se nevojat e Autoritetit Kontraktor. Për këtë arsye nuk mund të merret për bazë argumentimi i paraqitur nga operatori ekonomik, pasi mënyra dhe vendi ku do të kryhet skanimi nuk janë të shpërndara në mënyrë proporcionale.

Në praktikë, për nevojat e Autoritetit Kontraktor ndodh që të jetë e nevojshme skanimi i një numri të madh dokumentesh brenda një afati kohor të shkurtër, çka kërkon pajisje me performancë më të lartë.

Gjithashtu, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik është më e ulët se standardet e përcaktuara nga AKSHI, sipas të cilave shpejtësia e skanimit duhet të jetë jo më pak se 45 ppm/90 ipm (300 dpi).

Duke u bazuar në këto standarde, specifikimet teknike për shpejtësinë e skanimit ndryshohen si më poshtë:

Shpejtësia e Skanimit (Scanning Speed)

- Ishte: Min. 50 ppm/100 ipm (300 dpi)*
- Bëhet: Min. 45 ppm/90 ipm (300 dpi)*

Në lidhje me pikën d) - Treguesit sasiorë të shërbimit

Sasia e letrës nuk përputhet plotësisht me numrin e printimeve, pasi jo çdo printim realizohet vetëm në një anë të fletës (one-sided). Një pjesë e printimeve do të realizohen në të dy anët e fletës (double-sided).

Gjithsesi, kjo situatë nuk ndikon në përllogaritjen e fondit limit, si dhe nuk përbën kosto shtesë për operatorin ekonomik, pasi numri i fletëve të letrës është një zë më vete në përllogaritjen dhe faturimin që do të realizohet nga operatori ekonomik

Në lidhje me pikën e) Specifikimet teknike për softëare Pas rishikimit të specifikimeve teknike, u vendos që të hiqen specifikimet e detajuara mbi teknologjinë, databazën, serverin etj., ndërsa

operatori ekonomik do të ketë detyrimin të garantojë sigurinë e informacionit brenda Autoritetit Kontraktor.

Kërkesat për software-in e menaxhimit dhe monitorimit ndryshohen si më poshtë:

Menaxhimi dhe kontrolli i realizimit të shërbimit, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor, do të kryhet nëpërmjet përdorimit të një sistemi softëare të dedikuar. Ky softëare do të siguroher nga operatori ekonomik dhe duhet të garantojë sigurinë, funksionalitetin dhe vazhdueshmërinë procesit të punës. Gjithashtu, sistemi duhet të jetë plotësisht i përputhshëm dhe i integrueshëm me të gjitha pajisjet që do të ofrohen nga operatori ekonomik, duke munderuar menaxhimin dhe monitorim efektiv të shërbimit.

Për softëare-in e menaxhimit të pajisjeve të printimit, operatori ekonomik do të ketë akses vetëm për të parë numrin e faqeve të printuara dhe të fotokopjuara. Ky akses do të realizohet vetëm në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Ndërkohë, Sektori i IT-së do të jetë përgjegjës për menaxhimin e dokumenteve të fotokopjuara dhe të skamuara."

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

[...]

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

a) pranimin e plotë të ankesës;

b) pranimin e pjesshëm të ankesës;

c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK, për kundërshtimin e dokumentave të tenderit, referuar vendimit KSHA 45/2026, dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 571/3 prot., datë 17.03.2026, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 571/2026 prot., datë 24.02.2026 të operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për kundërshtimin e dokumentave të tenderit me pretendimin se: “ [...]Ankesë 2.3 Konkretisht kundërshtojmë specifikimet teknike dhe sasiore për skanimin dhe skanerat, si më poshtë: Pika 1: Në specifikime është kërkuar: Shpejtësia e Skanimit Scanning Speed : Min 50 ppm / 100 ipm (300 dpi) Refruar treguesve sasiore ku kërkohet numri i skanimeve total = 100, 000 (njëqind mijë) fletë për 36 muaj, përmes një veorimi të thjeshtë matematikor dalim në konkluzionin se: 100,000 fletë / 20 pajisje skaner / 36 muaj= 140 fletë skanimi në muaj për cdo pajisje. Në këtë kuptim, gjykojmë se nuk ka asnjë sens logjik, sasior, ligjor e menaxherial të kërkojë që shpejtësia e skanimit të jetë minimalisht 50 ppm (faqe në minutë) kur rezulton që secila pajisje skaner do të skanojë më pak se 140 faqe në muaj. Prandaj për sa më sipër, kërkohet që specifikimet e pajisjes skaner të modifikohen dhe të bëhen: Shpejtësia e Skanimit Scanning Speed : Min 20 ppm / 30 ppm (300 dpi) Specifikimet teknike për zerin Skaner tipi 3 janë copy paste të brandit Rihoh fi-8170 dhe me poshte po ju japim faktet dhe argumentimin ku e mbështesim kundërshtimin tone: Pika 2 Ja një krahasim i peshës së letrës (iMedia sizeni) që mbështet secili nga këta 3(tre) skanerë, krahasuar

me kërkesën 20460 g/m² që është kërkuar: 1. Ricoh fi-8170 ? Media size: 20 ñ 465 g/m² ? përputhet me kërkesën 20 ñ 460 g/m². Pra Ricoh fi-8170 e mbulon plotësisht kërkesën për peshë letre. 2. Canon imageFORMULA DR-G2090 Pjesërisht ? gamë e ngushtë se kërkesa: ? Media size:: 20 ñ 209 g/m² Canon DR-G2090 nuk mbështet material shumë të rëndë deri në 460 g/m², vetëm deri rreth 209 g/m². 3. Kodak Alaris S2085f Gama është pak më e kufizuar se kërkesa maksimale: ? Media size: 34 ñ 433 g/m²”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën nr. 6 të dokumentave të tenderit, “Formulari i specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

[....]

Skaner Tipi 3	
Karakteristika minimale teknike	
Tipi "Type":	CIS me Mekanizma per mbrojtjen e letrave
Formati "Format":	A4
Rezolucioni i Skanimit "Scanning	Min 600 dpi
Mënyra e Skanimit "Scan Mode":	Simplex dhe Duplex
Vendosja e Materialit "Media Feeder Type":	ADF
Kapaciteti i ADF "ADF Capacity":	Min 100 Fletë
Pesha specifike e letrës "Media sizes":	20-460 g/m ²
Shpejtësia e Skanimit "Scanning Speed":	Min 50 ppm / 100 ipm (300 dpi)
Ushqimi "Poëer Supply":	220 V AC, 50 Hz
Funksionet "Functions":	Pattern Noise Suppression, Edge Restoration, Punch Artifact Elimination, Detail Enhancement, Tab-Specific Cropping, Advanced Paper Safeguard ëith Smart Image Monitoring, Multi-Format Output Generation, Segmented Image Extraction, Standardized Color Output, Fixed Contrast Filtering, Fine Artifact Suppression
KOMUNIKIMI & MËNAXHIMI	
Porta e Komunikimit " Interface":	High-Speed USB 3.2
"Drivers" + OCR Softëare:	Po, per për kapjen e të dhënave me lexim të barkodit, eksportim në format PDF/A(Anglisht, Italisht, Gjermanisht), JPEG2000 dhe Microsoft Ëord. OCR me mundesi eksporti ne (CSV, TXT, XML) te te dhëna identifikuese te ID dhe pasaportave
AKSESORËT	

Ushqyes + Kabëll "Poëer Supply + Cord" + Stampues:	Po, European. Të stampoje identifikues (si data apo kode) në anën e pasme të dokumentave pas skanimit, për të shërbyer si provë e timestamp
CD/DVD Drivers and Softëare:	Po, duke perfshire mundesi per te lexuar te dhenat e pasaportave
Kabëll për Komunikimin e të Dhënave "Data Cable":	(1) USB Cable

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.3. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.2.4. Në nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të

përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u

referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm”.

KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet “*Specifikime teknike*” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për siguri të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika,

përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.” Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “specifikim teknik” nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Hollandës” *inter allia* dhe *mutatis mutandis* është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafruar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të

përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.2.6. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.7. Lidhur me pretendimin e ankimesit “PC Store” SHPK, për modifikimin e dokumentave të tenderit, konkretisht shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” duke kërkuar modifikimin e specifikimeve teknike konkretisht lidhur me shpejtësinë e skanimit me arsyetimin si vijon: *“Konkretisht kundërshtojmë specifikimet teknike dhe sasiore për skanimin dhe skanerat, si më poshtë: Pika 1: Në specifikime është kërkuar: Shpejtësia e Skanimit Scanning Speed : Min 50 ppm / 100 ipm (300 dpi) Refruar tregusve sasiore ku kërkohet numri i skanimeve total = 100, 000 (njëqind mijë) fletë për 36 muaj, përmes një veorimi të thjeshtë matematikor dalim në konkluzionin se: $100,000 \text{ fletë} / 20 \text{ pajisje skaner} / 36 \text{ muaj} = 140 \text{ fletë skanimi në muaj për çdo pajisje}$. Në këtë kuptim, gjykojmë se nuk ka asnjë sens logjik, sasior, ligjor e menaxherial të kërkosh që shpejtësia e skanimit të jetë minimalisht 50 ppm (faqe në minutë) kur rezulton që secila pajisje skaner do të skanojë më pak se 140 faqe në muaj. Prandaj për sa më sipër, kërkohet që specifikimet e pajisjes skaner të modifikohen dhe të bëhen: Shpejtësia e Skanimit Scanning Speed : Min 20 ppm / 30 ppm (300 dpi)”, Komisioni konstaton, se në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar: shpejtësia e skanimit **Min 50 ppm / 100 ipm (300 dpi)**, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt-prokurimi të jenë të cilësisë maksimale. Komisioni gjykon, se bazuar në specifikat e veçanta të pajisjes objekt prokurimi si dhe bazuar në përdorimin e saj, referuar vendimit KSHA 45/2026 me nr. 668/9 prot., datë 11.03.2026 prot., protokolluar pranë KPP-së me nr. 571/2 prot., datë 13.03.2026 autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht pretendimin e operatorit ekonomik “PC Store” SHPK duke modifikuar specifikimet teknike lidhur me shpejtësinë e skanimit në **Min 45 ppm / 90 ipm (300***

dpi), si dhe ka sqaruar operatorin ekonomik në mënyrë shteruese lidhur me treguesit sasiorë të shërbimit.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik për modifikimin e shpejtësisë së skanerit në *20 ppm / 30 ppm (300 dpi)*”, nga verifikimi i Specifikimeve Teknike “Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për përdorim zyre” për vitin 2025 të Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit, Komisioni konstaton se për skanerin e tipit 3 është përcaktuar shpejtësinë e skanimit në **Min 45 ppm / 90 ipm (300 dpi)**, rrjedhimisht pas modifikimit të kryer nga autoriteti kontraktor rezulton që shpejtësia e skanimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është në përputhje me standardin kombëtar të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere/specifikime teknike të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë. Vlen të theksojmë se nga ana e autoritetit kontraktor referuar vendimit KSHA 45/2026 me nr. 668/9 prot., datë 11.03.2026 prot., protokolluar pranë KPP-së me nr. 571/2 prot., datë 13.03.2026 autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht pretendimin e operatorit ekonomik “PC Store” SHPK duke modifikuar specifikimet teknike lidhur me shpejtësinë e skanimit në **Min 45 ppm / 90 ipm (300 dpi)**, referuar standardit kombëtar të përcaktuar nga AKSHI, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik për modifikimin e specifikimit teknik në 20 ppm / 30 ppm (300 dpi) nuk qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “PC Store” SHPK për modifikimin e dokumentave të tenderit me arsyetimin si vijon: “[...] 2. KËRKESA 2.3.3: “a. 2 (dy) inxhinierë të cilet duhet të jene të diplomuar ne fushat: teknologji informacioni IT/ informatike/ inovacion/ elektronike/ inxhinieri mekanike. Per keta punonjës te paraqitet diploma e arsimit te larte dhe kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues. b. 3 (tre) punonjës teknikë te cilet do te kryejne funksionin e mirembajtjes se paisjeve dhe do te realizojne asistencen teknike gjate kryerjes se sherbimi. Per keta punonjës te paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues. c. 3(tre) nga punonjesit e mesiperm te permendur ne piken a dhe b, duhet te jene te trajnuar/ certifikuar nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar te paisjeve (pika 2.3.2 tabela nr.1-5) te ofertuara ne kete procedure prokurimi ose nga organe te akredituar

kompetente, per sherbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Ne lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe çertifikimi perkates. d. Nje punonjes (mund te pershihen edhe punonjesit e pikes a dhe b) duhet te jete i certifikuar per konfigurimet ne rrjet ne nivel CCNA ose ekuivalent. Ne lidhje me kete punonjës të paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues dhe çertifikimi perkates. **DUHET TË MODIFIKOHET DHE TË BËHET:** “a. 2 (dy) inxhinierë te cilet duhet te jene te diplomuar ne fushat: teknologji informacioni IT/ informatike/ inovacion/ elektronike/ inxhinieri mekanike. Per keta punonjës te paraqitet diploma e arsimit te larte dhe kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues. b. 3 (tre) punonjës teknikë te cilet do te kryejne funksionin e mirembajtjes se paisjeve dhe do te realizojne asistencen teknike gjate kryerjes se sherbimi. Per keta punonjës te paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues. c. 3(tre) nga punonjesit e mesiperm te permendur ne piken b, duhet te jene te trajnuar/ certifikuar nga prodhuesit e pajisjeve obejkt prokurimi ose ekuivalentët e tyre (pika 2.3.2 tabela nr.1-5) ose nga organe te akredituar kompetente sipas ligjit për arsimin profesional. Ne lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe çertifikimi perkates dhe kontrata e punës. ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1 Në shtojcën nr. 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në pikën 2.3.3 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

a. 2 (dy) inxhinierë te cilet duhet te jene te diplomuar ne fushat: teknologji informacioni IT/ informatike/ inovacion/ elektronike/ inxhinieri mekanike. Per keta punonjës te paraqitet diploma e arsimit te larte dhe kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

b. 3 (tre) punonjës teknikë te cilet do te kryejne funksionin e mirembajtjes se paisjeve dhe do te realizojne asistencen teknike gjate kryerjes se sherbimi. Per keta punonjës te paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

c. 3(tre) nga punonjesit e mesiperm te permendur ne piken a dhe b, duhet te jene te trajnuar/ certifikuar nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar te paisjeve (pika 2.3.2 tabela nr.1-5) te ofertuara ne kete procedure prokurimi ose nga organe te akredituar kompetente, per sherbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Ne lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe çertifikimi perkates.

d. Nje punonjes (mund te pershihen edhe punonjesit e pikes a dhe b) duhet te jete i certifikuar per konfigurimet ne rrjet ne nivel CCNA ose ekuivalent. Ne lidhje me kete punonjës të paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues dhe çertifikimi perkates.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.3.2. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.3. Në nenin 41, pikat 2 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.

III.3.4. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.3.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “PC Store” SHPK për kundërshtimin e dokumentave të tenderit lidhur me kriterin e veçantë të kualifikimit pikës **2.3.3. pika (c)**, konkretisht për modifikimin si vijon: “c. 3(tre) nga punonjesit e mesiperm te permendur ne piken b, duhet te jene te trajnuar/ certifikuar nga prodhuesit e pajisjeve obejkt prokurimi ose ekuivalentët e tyre (pika 2.3.2 tabela nr.1-5) ose nga organe te akredituar kompetente sipas ligjit për arsimin profesional. Ne lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe çertifikimi perkates dhe kontrata e punës.”, si dhe nga verifikimi i dokumentave të tenderit Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3. autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: “2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

a. 2 (dy) inxhinierë te cilet duhet te jene te diplomuar ne fushat: teknologji informacioni IT/ informatike/ inovacion/ elektronike/ inxhinieri mekanike. Per keta punonjës te paraqitet diploma e arsimit te larte dhe kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

b. 3 (tre) punonjës teknikë te cilet do te kryejne funksionin e mirembajtjes se paisjeve dhe do te realizojne asistencen teknike gjate kryerjes se sherbimi. Per keta punonjës te paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

c. 3(tre) nga punonjesit e mesiperm te permendur ne piken a dhe b, duhet te jene te trajnuar/ certifikuar nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar te paisjeve (pika 2.3.2 tabela nr.1-5) te ofertuara ne kete procedure prokurimi ose nga organe te akredituar kompetente, per sherbim

mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Ne lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe certifikimi perkates.

d. Nje punonjes (mund te pershihen edhe punonjesit e pikes a dhe b) duhet te jete i certifikuar per konfigurimet ne rrjet ne nivel CCNA ose ekuivalent. Ne lidhje me kete punonjës të paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues dhe certifikimi perkates.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor”. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, referuar kriterit të veçantë të kualifikimit, si dhe dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa e autoritetit kontraktor që 3 punonjës duhet te jene te trajnuar/ certifikuar nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar te paisjeve te ofertuara ne kete procedure prokurimi ose nga organe te akredituar kompetente, per sherbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Nisur dhe nga specifikimet teknike të procedurës së prokurimit, pasi objekti i procedurës nuk lidhet vetëm në ofrimin e shërbimit mekanik të printimit, por përfshin instalimin, konfigurimin, integrimin dhe funksionimin e pajisjeve të printimit në infrastrukturën ekzistuese të rrjetit të Autoritetit Kontraktor, KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor është proporcionale me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Akoma më tej KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor nuk është diskriminuese dhe nuk cënon konkurrencën, pasi është gjithëpërfshirëse, duke kërkuar që vetëm 3 nga 5 punonjës të kenë certifikim per sherbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike, duke lënë një diapazon të hapur, si dhe nuk ngushton konkurrencën pasi ka lënë të hapur mundësinë që certifikimi të jetë nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar të paisjeve të ofertuara në këtë procedure prokurimi ose nga organe të akredituar kompetente. Në këtë mënyrë kjo kërkesë është në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe siguron trajtim të barabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë pasi i lejon operatorët ekonomikë të interesuar që ky kriter të përmbushet nga cilido prej stafit që zotëron certifikimet, stafi inxhinierik ose stafi teknik. Gjithashtu autoriteti ka lënë të hapur mundësinë që certifikimi të jetë nga prodhuesit apo distributoret e autorizuar të paisjeve të ofertuara në këtë procedure prokurimi ose nga organe të akredituar kompetente, për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisjesh elektronike, rrjedhimisht kërkesa e autoritetit kontraktor nuk kufizohet vetëm në një subjekt lëshues, por ka përcaktuar edhe organe të akredituara kompetente për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisje elektronike. Akoma më tej Komisioni gjykon, se certifikimi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar që stafi i kërkuar zotëron njohuritë profesionale për ekzekutimin me sukses të kontratës. Në këtë kuadër, KPP e gjykon të drejtë këtë

kërkesë të autoritetit kontraktor dhe i shërben realizimit me sukses të kontratës. **Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.**

III.4.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “PC Store” SHPK për kundërshtimin e dokumentave të tenderit lidhur me kriterin e veçantë të kualifikimit pikës **2.3.3. pika (d)**, konkretisht për modifikimin e tij me arsyetimin si vijon: *“Vërejmë që në shkronjën d) të pikës 2.3.3 është kërkuar si vijon: “d. Nje punonjes (mund te pershihen edhe punonjesit e pikes a dhe b) duhet te jete i certifikuar per konfigurimet ne rrjet ne nivel CCNA ose ekuivalent. Ne lidhje me kete punonjës të paraqitet kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues dhe certifikimi perkates.” Nga verifikimet tona edhe të mbështetura në argumentimin e paraqitur nga AK, gjykojmë se kriteri është tërësisht jashtë qëllimit të objektit të prokurimit pasi AK nuk do të ndërtojë një rrjet interneti të brendshëm nga fillimi apo infrastrukturë të re rrjeti, por vetëm do të lidhë me burimin e energjisë dhe në rrjetin ekzistues të AK disa pajisje për printimin e fotokopjimin e dokumentave të përditshme institucionale”, Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konkretisht të shtojcës 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, konstaton se kemi të bëjmë me një shërbim printimi, por që përfshin instalimin, konfigurimin, integrimin dhe funksionimin e pajisjeve të printimit në infrastrukturën ekzistuese të rrjetit. Gjithashtu referuar dokumentave të tenderit, Komisioni konstaton, se Shërbimi do të shtrihet në disa vende, pasi Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë përfshin Krujë, Fushë Krujë, Vorë, Kamëz, Tiranë dhe shërbimi për printimin dhe pajisjen me printera duhet të garantojë: Mbulesë të plotë territoriale, Reagim të shpejtë në rast ndërhyrjeje teknike, Prezencë të stafit teknik për pikat përkatëse.*

III.4.1. Në rastin konkret lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për 1 një punonjës të certifikuar për konfigurimet në rrjet në nivel CCNA ose ekuivalent, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa për 1 një punonjës të certifikuar për konfigurimet në rrjet në nivel CCNA ose ekuivalent i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Nisur dhe nga specifikimet teknike, referuar dokumentave të tenderit objekti i procedurës nuk lidhet vetëm në ofrimin e shërbimit mekanik të printimit, por përfshin instalimin, konfigurimin, integrimin dhe funksionimin e pajisjeve të printimit në infrastrukturën ekzistuese të rrjetit të Autoritetit Kontraktor, KPP gjykon, se kërkesa për 1 një punonjës të certifikuar për konfigurimet në rrjet në nivel CCNA ose ekuivalent është proporcionale me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Akoma më tej referuar procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, autoriteti kontraktor ka argumentuar teknikisht se përse shërben që ofertuesi të disponojë në stafin e tij një punonjës të certifikuar për konfigurimet në rrjet në nivel CCNA ose ekuivalent. Gjithashtu, referuar kriterit të veçantë të

kualifikimit autoriteti kontraktor në hartimin e këtij kriteri ka përcaktuar edhe termin ekuivalent në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. KPP gjykon, se ky kriter është i përshtatshëm për arritjen e synimit të kërkuar dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin duke përmbushur në këtë mënyrë edhe testin e proporcionalitetit në lidhje me hartimin e tij. Në këtë kuadër, KPP e gjykon të drejtë këtë kërkesë të autoritetit kontraktor, që operatorët ekonomikë të kenë në stafin e tyre 1 një punonjës të certifikuar për konfigurimet në rrjet në nivel CCNA ose ekuivalent prandaj pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për këtë kërkesë nuk qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 *“Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”* Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75971-02-12-2026, me objekt: “Shërbim Printimi i Menaxhuar”, me fond limit 31,207,000 (tridhjetë e një milion e dyqind e shtatë mijë) Lekë pa TVSH ose 323,690 (treqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) euro pa TVSH lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës dhe Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës, që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

